



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 432 Prot

Tiranë, më 01.04.2019

Nr. 1253 Dosje

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 150, të lëshuar më datë 08.06.2018 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr. 1253, Datë 26.02.2019 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut I.SH.M.T, ndaj debitorit “Robert Hoxha”, person fizik, me Nr. NIPT-i: K37210201L, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim Përfundimtar i Inspektimit Nr. 182/2, datë 01.03.2018.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 410 Prot, Datë 28.02.2019 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 150, Datë 08.06.2018, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori “Robert Hoxha”, person fizik, me Nr. NIPT-i: K37210201L, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit, dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të vijoj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër duke vënë sekuestër mbi aksionet e debitorit “Robert Hoxha”, person fizik, me Nr. NIPT-i: K37210201L në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Për sa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i I-re) të Ligjit Nr.10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbardimor Gjyqësor Privat”, si dhe Nenit 2, pika 6, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”



URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:

a) “Robert Hoxha”, person fizik, me Nr. NIPT-i: K37210201L,

Dhe

b) Z. Robert Hoxha (atësia: Hajredin, i datëlindjes: 01.02.1963)

Pranë Shoqërisë:

a. “RVK3” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: L96511203A

2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:

a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.

b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.

c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.

3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.

4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri

6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO

